

Im bir dhe rrezja e diellit

vjersha

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

824-1

Z 17

MIRA  
ZAIMASI





Mira Zaimasi ka lindur në Berat në vitin 1950.

Shkollën 8 Vjeçare e shkollën pedagogjike i kreu në qytetin e lindjes.

Më 1967 filloi punën si arësimitare; studimet e larta në degën gjuhë-letërsi i mbaroi me korrespondencë. Nga viti 1969 e këndej punon si redaktore në gazetën «Përpara» të Korçës.

Ky është libri i saj i parë.

8241  
£17.

MIRA ZAIMASI

# IM BIR DHE RREZIA E DIELLIT

— vjersha —

BIBLIOTHEKA E SHQETIT  
 GJUROR-ASTER  
 INV ~~6727~~

14196

Forma 70x100/32      Shpreh: 2004-73

SHTETIA BOTUESE «NAIM FRASHERI»



**Redaktor: Vehbi Skënderi**  
**kopertina nga Svjetllana Strazimiri**

**Tirazhi 3000 kopje      Format 70x100/32      Stash: 2204-72**

---

**Shtyp. Drejtoria Qëndrore Poligrafike**  
**Shtypshkronja «8 Nëndori» — Tiranë, 1972**

## QESHJES SË FËMIJVE

Pranvera shkundi petale nga gjiri i saj,  
faqeve të fëmijve,  
për ta bërë më të bukur fytyrën e tyre.  
Pranvera u fali ndriçim, nga dielli i saj  
syve të tyre.

A ka më të shkëlqyeshëm se sytë e fëmijve?  
Çdo nënë i fal një tingullimë qeshjes së tyre,  
për ta bërë më të kumbueshme atë qeshje të çiltër.

## PRITJA

Ku je, ku je Margaritë?  
Sa je rritur vallë qysh nga ajo ditë,  
kur pjeshkët ulen kryet  
dhe dielli mbylli sytë,  
por mbeti mes nesh buzëqeshja jote.

Sytë e tu — dete plot ëndërra e dëshira  
dhe konturet e së ardhmes, që feksen dhe më  
shumë.

Ku je, ku je Margaritë?  
Sa je rritur vallë qysh nga ajo ditë  
sa këngë na mbinë mbi buzët e thara për ty?  
Dhe lindën midis këngëve  
fëmijë,

që mbajnë emrin tënd,  
që kanë sytë e tu  
edhe këndojnë këngën  
«Ku je Margaritë?»

## PROLOG

J. Naçit

Lika,  
kur ishim të vogla ne njëzetvjeçaret  
nënat na lidhnin fjongo në kokë,  
na vishnin fustane e këmishë me oja,  
megjithëse tek-tuk na kish rënë ndonjë dhëmb,  
megjithëse donim tërë ditën bukën në dorë  
e ktheheshim në shtëpi me duar të ndotura.  
Kur agimi qeshte,  
lule hidhte tek dritaret tona;  
nënat nuk përtuan kurrë t'i mblidhnin,  
ndërsa na thoshnin neve shpesh:  
«Janë për dasmat tuaja»  
si do të ishin vallë, Lika,  
këto dasmat tona?

\* \* \*

Si pëllumba të bardhë fluturuan vjetët e fëminisë,  
fluturuan dhe u ndalën në zemrat e nënave  
si në një stacion të përjetshëm.

A do ta humbë ndonjë ditë gjallërnë  
ky stacion i çuditshëm?

Atëhere nënat na dhanë në dorë një gjilpërë,  
(duhet të mendonim dhe ne për jetë)  
ndonse dielli na thërriste në oborr  
të losnim me moshatarët

e ç'mund të mendonim të tetë pranverat tona Lika  
që kishin gishtat e hollë  
dhe sytë nga dritarja?

\* \* \*

Mbasditet na gjenin ulur tek porta.

Sa fustane grisëm gurëve, të kujtohet Lika,  
mbasditet na gjenin me qendismë përpara,  
mbasditet mblidhnin supet e gjera:

«Mos donin ta futnin botën në qëndisma  
këto vajza kokëulura?»

Atëhere

sa herë i shpuam gishtat e hollë!



\* \* \*

Një ditë, ashtu si rastësisht,  
u bëmë për nënat shoqëruese nderi;  
s'kishin të mbaruar vizitat nëpër teto e miq,  
këshillat e mamasë, përkujdesjet.  
Kur do të mbaronin këto vizita të gjata,  
që donin t'u pengonin vrapin vjetëve tona çapkëne?  
Kur do të mbaronin këto biseda të gjata  
për pajat?

Kur do të loznin vallë mbasditet me ne,  
shkarkuar nga ky shqetësim i madh i nënave?

Ti e di.

Kështu u hapën sëndyqet me radhë,  
kështu u pudrosën pajat me naftalinë,  
nënave të dashura me zemra të bardha  
brenda sëndyqeve zemrat iu nxinë  
po ne që i kishim zemrat — diell  
a do t'ia mbyllnim diellit synë?

\* \* \*

Sa lotë e dridhje kur kishim qiraxhiq!  
Jo. Neve na dehte  
aroma e pranverës.  
Në gjji të saj po mbillnim ne lule,  
që t'ua dhuronim njerëzve të dashur,  
që t'ia dhuronim tërë mëhallës,

mëhallës që rrinte tek porta mbasdite  
me përparset me oja e shtizat në dorë,  
sikur do të endte rrugët e vajzave.  
Po lulet tona janë erëkëndshme.  
Po e deh aroma e tyre tërë mëhallën.  
Dhe nënat tona të merakosura për ne  
vënë buzën në gaz  
e nxjerrin në diell sëndyqet të marrin ajër.  
Po i shëndosh, Lika, dhe zemrat e njerëzve  
ky ajër i magjishëm.